

01-1832

	<p>Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p>Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina</p>	<p style="text-align: center;">PRISHTINA</p> 
---	--	--

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-03 dt.21.06.2016, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, dhe në bazë të kërkesës 05 Nr 350/ 02-142355/25 dt. 17.09.2025 (sipas E-leja KKN-00545), të aplikuesëve/bashkëpronarëve Mustafë dhe Kadire Kllokoqi me adresë në Rr. Ramiz Kovaqi,Bll.1, B26 në Prishtinë, për caktimin e kushteve ndërtimore në hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor për ndërtimin e shtëpisë individuale banimore/ shtëpisë familjare, në kuadër të bllokut urban "F-02", të tërësisë urbane “F”, të Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia” 2016-2024”, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 20.04.2026 merr këtë:

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I Caktohen kushtet ndërtimore aplikuesve/bashkëpronarëve Mustafë dhe Kadire Kllokoqi nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 350/ 02-142355/25 dt. 17.09.2025 (sipas E-leja KKN-00545), për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për ndërtimin e ndërtesës /shtëpisë individuale të banimit, me etazhitet B+P+1, në kuadër të bllokut urban "F-02", të tërësisë urbane “F”, të Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia/ 2016-2024”, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 00897-0, ZK Sofali;

II. Lokacioni i parcelës kadastrale të lartcekur, për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, përfshihet në kuadër të Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia 2016-2024”, i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 031-247790 dt. 04.10.2016, dhe kjo zonë është e planifikuar me destinim “Banim individual i ulët”.

Për kriteret urbane, parametrat dhe kushtet e ndërtimit sipas dokumenteve të planifikimit hapësinor, pronari është informuar përmes “Shkresës” Informim nga Plani Rregullues i Hollësishëm Sofalia 2016-2024”, me referencë 04-350/01-51586/26, lëshuar me datë 15.04.2025 nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik e Komunës së Prishtinës.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit - parcelës kadastrale të trajtuar, sipas gjendjes kadastrale, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor, është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, është:
 -nr.00897-0, ZK Sofali ... S=592m²,... Mustafë dhe Kadire Kllokoqi,... “Arë e Klasës 6” ;
- E drejta pronësore-juridike është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;
- Bazuar në gjendjen faktike dhe incizimin gjeodezik të lokacionit, në kuadër të parcelës kadastrale të trajtuar, nuk ka ndërtim;
- Është tokë urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj;
- Terreni është i relativisht i pjerrët, me disnivel ~3m’ në drejtimin lindje-perëndim;
- Qasja në parcelën kadastrale është përmes Rr. Voskopoja;

- Në kuadër të perimetrit prej 50m’ të parcelës kadastrale në fjalë, përfshihen ndërtesa individuale banimore, dhe ndërtesa tjera kryesisht me ndërtime të ulët;

IV. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor, për rregullimin e hapësirës dhe realizimin - ndërtimin e shtëpisë individuale banimore/shtëpisë familjare, sipas gjendjes së planifikuar në kuadër të Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia 2016-2024”, në Prishtinë, përcaktohen duke konsultuar dhe analizuar dokumentet e planifikimit hapësinor, rregullativën ligjore në fuqi dhe projekt propozimin /projektin konceptual, dhe ato do të jenë:

- Organizimi me qasja në parcelë, pozicionimi, gabariti dhe etazhiteti i ndërtesës/shtëpisë, raporti i saj me vijën rregulluese dhe atë ndërtimore, si dhe distancat nga kufiri i parcelës, rrugët dhe vend parkimet e planifikuara, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Planin e lokacionit- “zgjdhja urbane”, bashkëngjitur këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore;
- Destinimi i shfrytëzimit, sipas Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia 2016-2024”, është e planifikuar me destinim “Banim individual i ulët”, me hapësira përcjellëse, si: kthina teknike, depo, hapësira për parking, etj. (sipas projektit konceptual të prezantuar);
- Etazhiteti maksimal i lejuar, sipas planit rregullues, është P+2, kurse i propozuar dhe i miratuar është B+P+1;
- Me këto kushte ndërtimore në kuadër të parcelës kadastrale nr. 00897-0, ZK Sofali, planifikohet ndërtimi i një shtëpie individuale banimore-shtëpi familjare, me sipërfaqe ndërtimore, shtrirje dhe etazhitet, sipas llogarive dhe projektit konceptual, si në vijim;
 - $S = 164,92m^2$ / sipërfaqe nëntokësore ndërtimore;
 $S = 592.0 \times 0.5 = 296.0m^2$ - e lejuar;
 - $S = 329.84 m^2$ / sipërfaqe mbitokësore ndërtimore;
 $S = 592.0 \times 0.8 = 473.60m^2$ - e lejuar;
 $S = 494.76m^2$ / sipërfaqe totale ndërtimore;
 - Etazhitet; **B+P+1.**
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës ndërtimore - brenda vijës rregulluese (ISHP), për vendosjen e ndërtesës në bazë-gabarit të përdhësës ose suterren, sipas Planit zhvillimor Komunal është max. 30%;
 - $S = 592.0 m^2 \times 0.3 (30\%) = 177.60 m^2$ / sipas Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia”,
 - $S = 164.92 m^2 / \sim 27 \%$, sipas projekt propozimit;
- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të parcelës ndërtimore për nëntokë (ISHPN), për vendosjen e ndërtesës në bazë - gabarit të bodrumit, sipas Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia” 2016-2024, është max. 50%, ndërsa pjesa e bodrumit që del jashtë gabaritet të objektit në përdhësë nuk duhet të jetë mbi nivelin e tokës”, është max 0.5 (50 %);
 - $S = 592.0 m^2 \times 0.5 (50\%) = 296.0 m^2$ / sipas Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia”,
 - $S = 164,92 m^2 /$, sipas projekt propozimit;
- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore për sipërfaqet gjelbëruese – (ISHGJ), me gjelbërim të lartë dhe të ultë, Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia” 2016-2024, është min. 50%;
 - $S = 592.0 m^2 \times 0.5 (50\%) = 296.0 m^2$ / sipas Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia”,
 $S = 348.78 m^2$; / sipas projekt propozimit/.
- Koeficienti i shfrytëzimit të sipërfaqja e përgjithshme ndërtimore (ISPN) sipas Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia” 2016-2024, është 0.8 (80%). Koeficienti ndërtimor i parcelës kadastrale brenda vijës rregulluese - parcelës ndërtimore, do të llogaritet si në vijim: 100% për etazhet mbi kuotën ± 0.00 , 50% për etazhet me vëllim mbi 51% mbi tokë - suterren, dhe 0% për etazhet e nëntokës - bodrume.
 - $S = 592.0m^2 \times 0.8 (80\%) = 473.60 m^2$ / sipas “Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia”,
 - $S = 329.84 m^2$ / sipas projekt propozimit;

- Distanca e vendosjes së ndërtesës ndaj kufirit të parcelës, për kthina primare min 0.5 H, për kthina sekondare min.0.2 H, dhe marrëveshja me fqinjtë deri në bashkim të plotë;
- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt.14.08.2016 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të shfrytëzimit eficient të energjisë, sipërfaqja që zë shtesa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë të lejes ndërtimore;
- Kati përdhësë i ndërtesës, për tu konsideruar kat i plotë, duhet të jetë së paku 1,4 m' mbi sipërfaqen tokësore, duhet të ketë së paku 2/3 të sipërfaqes së vet në lartësi minimale prej 2,3 m;
- Qasja në parcelë është përmes rrugës ekzistuese Rr. Voskopoja, në gjendje faktike rrugë dhe njëkohësisht është rrugë e planifikuar e Bllokut "F-02", sipas "Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia";
- Për shtëpi individuale banimi duhet të sigurohet 1 vend parking, për njësi banimi. Vend parkimi i jashtëm mund të planifikohet brenda vijës rregulluese duke mos e tejkaluar kushtin prej 50 % për gjelbërim;
- Në kuadër të parcelës të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- Arkitektura/dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të eficientësisë së energjisë, dhe ti përshtatet ambientit për rreth;
- Zgjidhja e kulmit duhet të projektohet dhe të ekzekutohet ashtu që të jetë në harmoni me projektin arkitektonik dhe uji i strehëve duhet të derdhet brenda parcelës ndërtimore.
- Të bëhet aplikimi i të gjithave kushteve tjera urbane dhe arkitektonike të përcaktuara në kriteret dhe parametrat urban të sipas Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia", si dhe me normat dhe standardet tjera të planifikimit.

V. Kyçja në infrastrukturë - marrja e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina", bëhet me aplikim nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin-adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për elektrike dhe ujë).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga "Termokos"-Ngrohtorja e Qytetit sh.a. dhe PTK.

VI. Dokumentacioni ndërtimor - projekti ideor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse dhe të licencuar për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV, projekt propozimin e prezantuar, normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Planin e situacionit të gjerë, në diametër prej 50m', me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:500 apo 1:1000, punuar në bazë të incizimit gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesës së projektuar dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Planin e situacionit të parcelës, në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë dhe me pozicionim të ndërtesës në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të platove, trotuareve, rrugëve dhe hyrjeve në përdhësë, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;

- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:100, për ndërtesën e projektuar, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Dukja e jashtme e ndërtimit, tredimensionale - perspektivë;
- Planin me vendin e qasjes në ujësjellës dhe kanalizim, në përpjesë 1:100;
- Planin me vendin e qasjes në furnizim me energji elektrike në përpjesë 1:100;
- Përshkrimin teknik të punëve ndërtimore;
- Paramasën dhe parallogarinë e punëve ndërtimore dhe ndërtimore zejtare;
- Detajet karakteristike dhe të nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20;
- Situacionin me përshkrimin teknik të "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim";
- Masat propozuese për fizikën ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma, me analiza dhe masa konkrete;
- Deklaratën e projektuesit për fazat e nevojshme;

VII. Pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore - meqenëse parcela kadastrale nr. 00897-0, ZK Sofali, në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, është e evidentuar me lloj të shfrytëzimit të parcelës-tokë bujqësore, "Arë e klasës 6" dhe të përshkruara në pikën 1 të paragrafit III. të këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore, kërkohet që paraprkasht të bëhet pagesa e kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, konform nenit 11,13 dhe 14 të Ligjit Nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore dhe nenit 8,9 dhe 14 të Udhëzimit Administrativ të MBPZHR Nr. 41/2006, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, që e rregullojnë këtë fushë.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, sipas Planit të situacionit - "zgjidhjes urbane", dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore, prej $S = 592 \text{ m}^2$. Kjo sipërfaqe bazuar në rregullativën ligjore në fuqi, do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.

Ky kompensim - pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

VIII. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të "Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01 nr. 434/01-0094474/17 dt. 24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të rimbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin/investitorin. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkëinvestim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuesit/ve (bashkëpronarëve të parcelës-ave dhe investitorit);

IX. Pagesa e taksës administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të realizohet sipas "Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01Nr.434/01-0094474/17

dt.24.04.2017 dhe bazuar në dokumentacionin ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

X. Vlefshmëria e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore do të jetë një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

Ar sy e t i m

Aplikuesit, Mustafë dhe Kadire Kllokoqi nga Prishtina, me kërkesën 05 Nr 350/02-142355/25 dt. 17.09.2025 (sipas E-leja KKN-00545), i janë drejtuar Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mjedisit të Komunës së Prishtinës, për caktimin e kushteve ndërtimore në hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit ideor për ndërtimin e shtëpisë individuale të banimit/shtëpisë familjare, në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitivit të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore. Me kërkesën për caktimin e kushteve ndërtimore aplikuesit kanë prezantuar këtë dokumentacion:

- *Dëshminë mbi pronësinë/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit për parcelën nr. 00897-0, të evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale P-71914066-00897-0 ZK Sofali, në emër të Mustafë dhe Kadire Kllokoqi, të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës;*
- *Ekstrakti aktit noterial ‘ Kontratë për shitblerje të paluajtshmërisë’ nga noter Burim Z.XHemajli me LRP. Nr.4089/2025 Nr. Ref.984/2025 dt.25.04.2025, lidhur në mes të Muhamet Selmanit shitsi dhe Mustafë dhe Kadire Kllokoqi blerës;*
- *Kredencialet e dokumentit të identifikimit të pronarit Mustafë Kllokoqi;*
- *Shkresën Informatën nga Plani Rregullues i Hollësishëm “Sofalia 2016-2024”, me Ref.nr 04-350/01-51586/26, lëshuar me datë 15.04.2025 nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik e Komunës së Prishtinës;*
- *Incizimi gjeodezik për parcelën kadastrale nr.897-0-0 ZK Sofali, i punuar nga Qëndrim Dragusha me nr. të licensës 255;*
- *Foto të lokacionit;*
- *Një kopje të dokumentacionit ndërtimor/projektit konceptual të ndërtesës /shtëpisë individuale të banimit, të hartuar nga Drenushë Lamaj Doli, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr. A 0790;*
- *Akti noterial “Pëlqim” i dhënë nga fqiu/ pronari i parcelës me nr.00893-1, për parcelën me nr.00893-2, ku pronari mund të ndërtoj në parcelën e vet në distancë 3m’nga kufiri i parcelës dhe mund të hap dritare primare, redaktuar tek noter Burim Z.Xhemajli me LRP. Nr.9514/2025 dt.08.10.2025;*
- *Akti noterial “Pëlqim” i dhënë nga fqiu/ pronari i parcelës me nr.00865-9 dhe 00865-7, për parcelën me nr.00893-2, ku pronari mund të ndërtoj në parcelën e vet në distancë 3m’nga kufiri i parcelës dhe mund të hap dritare primare, redaktuar tek noter Burim Z.Xhemajli me LRP. Nr.4093/2024 dt.28.04.2025;*

Drejtorja e Urbanizmit dhe Mjedisit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës 05 Nr 350/02-142355/25 dt. 17.09.2025 (sipas E-leja KKN-00545), dokumentacionit të prezantuar me prova të bashkangjitura, konsultimit të dokumenteve të planifikimit për hapësirën ku gjendet lokacioni - Plani Rregullues i Hollësishëm “Sofalia 2016-2024”, rregullativën ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit, ndërtimit dhe i procedurës së përgjithshme administrative, projektit konceptual, ka konstatuar se parcela kadastrale nr. 00897-0, ZK Sofali, shtrihet në kuadër të bllokut urban “F-02”, të “Plani Rregullues i Hollësishëm Sofalia 2016-2024”, i miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së

Prishtinës, 01 nr. 031-247790 dt. 04.10.2016, dhe kjo zonë është e planifikuar me destinim “Banim individual i ulët”.

Duke u bazuar në nenin 18 të Ligji Nr.04/L-110 për Ndërtim, pikën 1.2 dhe 1.2.2 të nenit 13 të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, kjo drejtori me datë 04.11.2025 ka vendosur njoftimin publik në hapësira të dukshme dhe frekuentuese të lokacionit dhe rrethinës në diametër prej 50 m`, për të njoftuar publikun me synimin e pronarit/ investitorit, për ndërtim, dhe i njëjti është lënë në dispozicion të tyre për 5 (pesë) ditë, për t`ju mundësuar të interesuarve paraqitjen e vërejtjeve dhe komenteve. Ky njoftim publik ka vazhduar të qëndrojë deri me datën 08.11.2025, dhe gjatë kësaj periudhe kohore, në postën elektronike zyrtare nuk ka arritur asnjë ankesë, kërkesë, vërejtje apo sugjerim nga qytetarët e asaj zone.

Ndërsa, pasi pjesë të parcelave kadastrale me nr. 00897-0, ZK Sofali, në bazë të certifikatës së njësisë kadastrale, janë të evidentuara me kulturë “Arë e klasës 6”, obligohet aplikuesi që paraprakisht aplikimit për leje ndërtimore, ta rregulloj këtë çështje, duke bërë pagesën e kompensimit për ndërrim të destinimit, konform dispozitave ligjore të Ligjit nr. 02/L-26 për Tokën Bujqësore.

Situacioni i parcelës në raport me vijën rregulluese dhe ndërtimore, Planit të situacionit-“zgjidhja urbane”, projektin konceptual në harmoni me koeficientin e shfrytëzimit të parcelës ndërtimore - (ISHP), distancat e vendosjes së ndërtesës ndaj kufirit të parcelës fqinje, dhe qasja në parcelën kadastrale në rrugën ekzistuese të lagjes, njëkohësisht është rrugë e planifikuar sipas Planit Rregullues të Hollësishëm “Sofalia/ 2016-2024”.

Në analizën e situacionit nga aspekti i komunikacionit dhe prezantuar në shkresën e zyrtarit-ekspertit për komunikacion, janë përcaktuar masat që duhet të ndërmerren, për kyçje të parcelës në rrugën ekzistuese të lagjes, dhe është konstatuar , si ne vijim:” Pas shiqimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të Mustaf Klllokoqi, në Sofali, lidhur me kërkesën për kushte ndërtimore të lëndës 05-350/02-142355/25 dt.17.09.2025, kyçja për automjete në rrugën e parapare me Planin Rregullues “Sofalia”, për ndërtesën shtëpi individuale me etazhitet B+P+1, të paraparë me këtë zgjidhje urbane, mund të pranohet si e till, marrë parasysh edhe gjendjen faktike të parcelës 897-0 Zk. Sofali ne raport me rrugën e planifikuar. Kyçja duhet ti përshtatet teknikisht rrugës planifikuar dhe ne kohën kur aplikohet ajo sipas planit, dhe të zbatohen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjes.”.

Bazuar në konstatimet e më sipërme dhe dokumentacionin e shqyrtuar, rregullativës ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenin 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 31.07.2013, nenin 13 të Udhëzim Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve”, Drejtorja e Urbanizmit dhe Mjedisit ka konstatuar se kërkuesi ka prezantuar të gjitha dokumentacionin e nevojshëm, se plani i situacionit – “zgjidhja urbane”, është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të planit rregullues urban për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë, u vendos si në dispozitiv të vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Dispozita urbanistike-”zgjidhja urbane” me ndërtesën e planifikuar, “Situacioni i parcelës me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga Plani Rregullues në sistem koordinativ KosovaREF01” të punuar nga kjo Drejtori.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja.

Ky vendim u printua në 4 (katër) kopje identike dhe i dërgohet: Aplikuesi, në dosje të lëndës, kësaj drejtorie dhe Qendrës për shërbim me qytetarë.

Kopja elektronike i dërgohet: Drejtorisë së Kadastrit dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik.

DREJTORIA E URBANIZMIT DHE E MJEDISIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS
05 NR. 350/02-142355/25 DT. 20.04.2026

Zyrtare,
Bahtie Uka



Udhëheqëse e Sektorit,
Nazife Krasniqi



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo


Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina



DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MJEDISIT

SITUACIONI I PARCELAVE ME VIJEN NDERTIMORE DHE RREGULLUESE NGA PLANI RREGULLUES NE SISTEMIN KOORDINATIV KOSOVAREF01

ZK. Sofall



Vija Rregulluese sipas PRRU	
1	7516274.78 4725293.45
2	7516276.90 4725293.72
3	7516278.95 4725294.33
4	7516280.87 4725295.27
5	7516282.61 4725296.51
6	7516284.13 4725298.02
7	7516285.37 4725299.75
8	7516286.25 4725301.52
Vija Ndërtimore sipas PRRU	
9	7516287.94 4725294.76
10	7516285.84 4725292.67
11	7516283.43 4725290.96


Punoi:
Kushtrim Domaneku.

Nënshkrimi: _____

Prishtinë: 26.03.2026

Legjenda:

-  Vija Rregulluese sipas PRRU
-  Vija Ndërtimore sipas PRRU
-  Parcelat Kadastrale



VËREJTJE:

KOMUNA : PRISHTINË
LAGJJA : "SOFALIA"
KUSHTET E RREGULLIMIT URBAN – TËRËSIA "F"
423-8 Biloku : F-02 - Banim Individual I Ulët (m²)
NR. I PARCELËS: P-71914066-00897-0
SIP. E PARCELËS: 592 m²
ISP = 0.3
592m²x0.3=177.6 m²
Shtëpia
Sbruto = 164.92m²
ISP = 0.8
592m²x0.8=473.6 m²
PËRDHESA = 164.92m²
KATI = 164.92m²
TOTAL = 329.84m²
ISGJ = 0.5
592m²x0.5=296 m²
192.43m² + 156.35m²
=348.78m²
ISN = 0.5
592m²x0.5=296 m²
BODRUMI=164.92 m²
NR. I KATEVE MAX P+2
SHTËPIA = B+P+1
VIJA NDËRTIMORE 5M



PROJEKTI IDEOR

Projektoi: BArch. Jetik Doli

Investitor: Mustafë KLLOKOQI

SHTËPI BANIMI SOFALI - PRISHTINË

ARKITEKTURA

SITUACIONI I NGUSHTË

ETAZHITETI: B+P+1

PËRPIJESA: 1:200

A3

DATE: MARS 2026

03

